Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit

PLATFORMA E SHËRBIMEVE ONLINE E-KOSOVA

Prishtinë, gusht 2025

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji[1] i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000 [1] dhe Udhëzuesin për Auditimin e Sistemeve të Informacionit (GUID 5100[2]).

Auditimet e teknologjisë së informacionit të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse për të fituar siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit[3], ekonomisë[4], dhe efektivitetit[5] të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kontrolleve përkatëse.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit "Platforma e shërbimeve online e-Kosova" në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Samir Zymberi, Drejtor i departamentit të auditimit;
Poliksena Berisha, Udhëheqëse e ekipit;
Gazmend Lushtaku, Anëtar i ekipit;
Atdhe Gashi, Anëtar i ekipit; dhe
Gëzim Krasniqi, Anëtar i ekipit.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa:Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria, Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011
http://zka-rks.org

[1] Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

[1] SNISA 3000 – Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike.

[2] GUID 5100 – Udhëzuesi për auditimin e sistemeve të informacionit lëshuar nga INTOSAI.

[3] Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës.

[4] Ekonomia –Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë.

[5] Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritura.

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave

ARC	Agjencia e Regjistrit Civil
AShI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
CAAT	Teknikat e auditimit me ndihmën e kompjuterit (Computer assisted audit techniques)
DDoS	Sulm i shpërndarë për mohimin e shërbimit Distributed Denial of Service
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IRK	Institucionet e Republikës së Kosovës
ISO/IEC	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim/Komisioni Ndërkombëtar Elektroteknik (International Organization for Standardization/International Electrotechnical Commission)
KRU	Kompania Regjionale Ujësjellësi
MAShTI	Ministria e Arsimit Shkencës Tekonologjisë dhe Inovacionit
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
QDhSh	Qendra e të Dhënave Shtetërore
SIDPSF	Sistemi i Informacionit të Departamentit për Politika Sociale dhe Familje
SSL	Shtresa e Lidhjes së Sigurt (Secure Socket Layer)
TI	Teknologjia e Informacionit

Përmbledhje e përgjithshme

Qeveria e Kosovës ka krijuar platformën "e-Kosova" si një nga zhvillimet për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike dhe për të rritur efikasitetin e administratës. Kjo platformë synon të lehtësojë qasjen e qytetarëve dhe bizneseve në shërbime publike përmes shërbimeve elektronike, duke reduktuar shpenzimet dhe nevojën për praninë fizike në sportele.

Platforma e-Kosova është një prej sistemeve me rëndësi shtetërore, e klasifikuar edhe në nivel vendi për rëndësinë që ka, e menaxhuar nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Aktualisht ofron rreth 230 shërbime publike në mënyrë elektronike dhe shërben si portë unike për qasje në shërbime nga institucione të ndryshme, duke kontribuar në transparencën dhe modernizimin e administratës publike.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit me fokusin e auditimit në shërbimet e kësaj platforme: "Shtesat për fëmijë", "Tatimi në pronë", "Subvencioni i librave" dhe moduli "Pagesat elektronike" për të vlerësuar nëse zbatimi i platformës e-Kosova i mundëson qytetarëve realizimin e shërbimeve elektronike efikase në mënyrë të saktë, të sigurt dhe të besueshme.

Platforma e-Kosova ka shënuar përparim të dukshëm në digjitalizimin e shërbimeve publike, duke përmirësuar qasjen, transparencën dhe efikasitetin në ofrimin e tyre për qytetarët dhe institucionet. Janë ndërmarrë hapa për vendosjen e mekanizmave teknik mbrojtës dhe ruajtjen e të dhënave dhe gjurmëve të auditimit, të cilat përbëjnë bazë të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të platformës. Megjithatë, për të ofruar funksionim të sigurt dhe të besueshëm, është e domosdoshme të adresohen mangësitë ekzistuese në kontrollet e brendshme, veçanërisht në aspektet që lidhen me kontraktimin, zhvillimin e sistemeve, si dhe kontrollin e të dhënave dhe sigurinë e informacionit.

Agjencia e Shoqërisë së Informacionit nuk ka vendosur standarde të mjaftueshme për menaxhimin e kontratave, për të shmangur paqartësitë në përgjegjësitë për sigurinë e informacionit. Në kontratat për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e kësaj platforme nuk është theksuar mjaftueshëm klauzola për mbrojtjen e të dhënave dhe reagimin ndaj incidenteve të sigurisë. ***Është zhvilluar shërbimi urgjent në platformën e-Kosova në mënyrë të pa planifikuar dhe jashtë procedurave standardeve për dokumentimin e zhvillimit të softuerit dhe projektimit teknik.*** Shërbimi është zhvilluar me vendimmarrje të përshpejtuar, pa dokumentacion të duhur, kritere teknike të qarta dhe kontratë aktive për subvencionimin e librave, duke rrezikuar cilësinë e zgjidhjeve dhe përmbushjen e objektivave të tyre funksionale.

AShI nuk garanton mjaftueshëm një mjedis të sigurt të informacionit për shkak të mungesës së politikave të azhurnuara dhe udhëzimeve operative për menaxhimin e qasjes dhe incidenteve. Ekzistojnë politika të vjetruara dhe masa të pamjaftueshme për ngritjen e ndërgjegjësimit të stafit, ndërsa mungon një infrastrukturë rregullative e plotë që adreson mbrojtjen e informacionit në mënyrë të qëndrueshme.

AShI nuk është e përgatitur për të rikthyer shërbimet në raste emergjente ose fatkeqësie, duke rrezikuar vazhdimësinë e operacioneve shtetërore elektronike. Mungon një plan i dokumentuar dhe testuar për rikuperimin nga fatkeqësitë; nuk ka qendra rezervë funksionale, ndërsa kopjet rezervë ekzistuese janë të pamjaftueshme për rikuperim të sigurt dhe në kohë. ***Mungesa e kontrolleve funksionale dhe teknike në aplikacionet e platformës e-Kosova ka krijuar rreziqe për saktësinë e të dhënave dhe integritetin e shërbimeve.*** Janë evidentuar mangësi në

ndërlidhjen e sistemeve për verifikimin e kritereve, përpunimin e të dhënave pa validime teknike, si dhe kontrolle të pa mjaftueshme që kanë rezultuar në aplikime të dyfishta dhe pagesa të përsëritura.

Platforma e-Kosova përballet me mangësi në kontrollet e aplikacionit, të cilat ndikojnë integritetin, saktësinë dhe sigurinë e të dhënave. Për shërbime si "Shtesat për fëmijë" dhe "Subvencionimi i librave", mungesa e ndërlidhjes së sistemeve për verifikimin e kritereve si "rezidenca" ka lejuar përfitimin pa plotësuar kushtet e nevojshme. Ndërlidhja e shërbimit për shtesat e fëmijëve me sistemin e brendshëm të MFPT-së ka sjellë aplikime të dyfishta dhe vështirësi në menaxhimin e pagesave. Mungesa e përditësimit të gjendjes së pagesës në kohë reale dhe kontrollet e dobëta në modulin e pagesave kanë lejuar pagesa të njëjta të ekzekutohen disa herë, duke krijuar pasoja financiare për qytetarët.

Edhe pse platforma siguron gjurmë unike dhe të identifikueshme për çdo transaksion, mungesa e monitorimit aktiv dhe periodik si pasojë e kapaciteteve të kufizuara njerëzore dhe mungesës së procedurave të standardizuara e kufizon aftësinë për të identifikuar në kohë ndërhyrjet e paautorizuara dhe aktivitetet e dyshimta.

Prandaj, rreziqet e identifikuara më lartë, tregojnë që Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit që administrojnë dhe ofrojnë shërbime përmes platformës e-Kosova kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e të dhënave dhe funksionimi i pandërprerë i shërbimeve të digjitalizuara. Lidhur me këtë, kemi dhënë gjithsej 15 rekomandime, nga të cilat 13 rekomandime për Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit dhe 2 rekomandime për Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit në koordinim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Lista e rekomandimeve, është paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

Përgjigja e entiteteve të përfshira në auditim

Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia për Shoqërinë e Informacionit dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve janë pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Platforma e-Kosova është platforma kryesore shtetërore ku shërbimet publike që gjenden në zyrat dhe sportelet fizike të institucioneve ofrohen në mënyrë elektronike për qytetarët, bizneset dhe vetë punonjësit e administratës publike.

Deri më tani kjo platformë ofron rreth 230 shërbime në formë elektronike, nga 658 shërbime qendrore dhe 100 shërbime lokale për secilën komunë, të cilat ofrohen në mënyrë fizike dhe elektronike.

Platforma e-Kosova, menaxhohet dhe administrohet nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. AShI është themeluar si agjenci ekzekutive qeveritare në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratën publike, ose pranë autoritetit më të lartë të administratës shtetërore të vendosur nga Qeveria dhe që tani është Ministria e Punëve të Brendshme.

Në vitin 2013, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin 04/L-145, në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për Organet Qeveritare të Shoqërisë së Informacionit i cili përcakton AShI-në si organin kryesor për zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

Përveç shërbimeve, që janë të zhvilluara në këtë platformë, gjithashtu janë ndërlidhur përmes Platformës së Interoperabilitetit (ndërveprimit) dhe ndërlidhjeve të drejtpërdrejta edhe shërbimet e tjera elektronike, të cilat menaxhohen nga institucionet tjera, por i ofrojnë shërbimet e tyre përmes e-Kosova si një portë e vetme elektronike për qytetarët.

Shërbimet që ofrohen në e-Kosova janë të ndara në 25 kategori, të cilat janë paraqitur në figurën në vijim.



Figura 1. Kategoritë e shërbimeve në e-Kosova

Këto shërbime lehtësojnë proceset administrative dhe ofrojnë një qasje më të shpejtë e më të lehtë për qytetarët. Ndër kategoritë më të përdorura të shërbimeve në këtë platformë janë Familja dhe Tatime. Te kategoria e familjes është përdor më së shumti shërbimi i shtesave për fëmijë, ndërsa tek tatimet shërbimi i tatimin mbi pronën.

Shërbimet më të shfrytëzuara në platformën e-Kosova, të cilat karakterizohen me qarkullim të të konsiderueshëm të mjeteve financiare mujore, janë "Shtesat për fëmijë" dhe "Tatimi në pronë". Tatimi në pronë është një shërbim i integruar nga një sistem fundor i jashtëm, i cili, përveç përdorimit të gjerë nga qytetarët, përmban edhe komponentën e pagesës, duke e rritur kështu ndjeshmërinë ndaj risqeve të mundshme. Po ashtu shërbimi i Subvencionit të librave shkollor është përfshirë për shkak të çështjeve të ngritura/ndërlidhura me Platformën e-Kosova, gjatë procesit auditues. Prandaj, Zyra Kombëtare e Auditimit ka orientuar fushëveprimin e saj auditues në këto kategori shërbimesh, për të adresuar çështjet kyçe të funksionimit të platformës e-Kosova, dhe ka planifikuar që auditimi i radhës në fushën e teknologjisë së informacionit të përqendrohet te sistemi i tatimit në pronë.



Figura 2. Përdorimi i shërbimeve në e-Kosova

Prandaj, në vijim do t'i trajtojmë më në detaje këto shërbime, duke analizuar proceset.

Shtesat për Fëmijë

Programi i Shtesave për Fëmijë është dizajnuar të zbatohet në mënyrë graduale, duke përfshirë grup mosha nga 0-16 vjeç.

Prindërit ose kujdestarët ligjorë mund të aplikojnë për shtesat e fëmijëve përmes platformës elektronike e-Kosova. Aplikimi kryhet online duke ndjekur hapat e mëposhtëm, ashtu edhe siç është paraqitur në figurën 3:



Figura 3. Aplikimi për shtesat për fëmijë

Pagesat e shtesave bëhen çdo muaj, zakonisht më datë 25 ose në ditën vijuese të punës, në llogarinë bankare të prindit ose kujdestarit që ka aplikuar. Afati për aplikim për shtesa të fëmijëve është i hapur nga data 01 deri më 10 të çdo muaji (aplikimi bëhet vetëm një herë, pastaj shtesa aplikohet çdo muaj deri në përmbushjen e kritereve).

Tatimi në pronë

Tatimi në pronë në Kosovë është një detyrim vjetor që aplikohet mbi pronat e paluajtshme, duke përfshirë tokat dhe ndërtesat. Ky tatim është një burim i rëndësishëm i të hyrave për komunat dhe përdoret për financimin e shërbimeve publike lokale.
Tatimi zbatohet mbi të gjitha pronat e paluajtshme, përfshirë tokat dhe ndërtesat, pavarësisht nga përdorimi i tyre (banim, biznes, bujqësi etj.).

Në figurën në vijim, është paraqitur mënyra se si mund të shkarkohet fatura e tatimit në pronë.



Figura 4. Fatura e tatimit në pronë

Pagesat elektronike përmes e-Kosova

Komponenta eKosovaPaymentGateway paraqet ueb aplikacionin që shfrytëzohet si ndërmjetësues mes e-Kosova dhe sistemeve të bankave të ndryshme për qëllime inicimi dhe kontrollimi të pagesave, që është njëra prej moduleve më të ndjeshme për qytetarin dhe sigurinë e informacionit.

Të gjitha shërbimet që realizojnë pagesa përdorin këtë modul. Pas klikimit në opsionin "Paguaj" në cilindo shërbim që përmban pagesë hapet moduli i pagesës sikurse në figurën në vijim.



Figura 5. eFatura për realizimin e një pagese elektronike në eKosova

Siç është paraqitur në figurën 4, moduli për Pagesat elektronike, shfaq të gjitha të dhënat e pagesave, duke përfshirë edhe informatat për "Bankat procesuese".

Siguria e të dhënave në e-Kosova

Mekanizmat të cilët janë implementuar për të ofruar siguri në të gjitha komponentet e platformës e-Kosova janë përmes firewall-ëve, ruajtjes së gjurmëve të auditimit dhe mekanizmave të autentikimit.

2 Objektivi dhe fushat e auditimit

Objektiv i këtij auditimi është të vlerësohet se zbatimi i platformës e-Kosova i mundëson qytetarëve realizimin e shërbimeve elektronike efikase në mënyrë të saktë, të sigurt dhe të besueshme.

Me këtë auditim synojmë që të ofrojmë rekomandime relevante për MPB-në, AShI-në dhe subjektet përgjegjëse në mënyrë që të përmirësojnë sistemin e informacionit lidhur me sigurinë e informacionit dhe zhvillimin dhe kontrollet e aplikacionit.

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit, jemi fokusuar në fushën e sigurisë së informacionit dhe kontrollet e aplikacionit, si dhe çështje që lidhen me politikat e kontraktimit dhe vazhdimësisë së biznesit duke i përzgjedhur fushat e auditimit si në vijim:

Tabela 2: Fushat dhe çështjet e auditimit

Fushat e auditimit	Çështjet e auditimit
1. **Kontraktimi**	1. Siguria
2. Blerja dhe zhvillimi	2. Analizimi, prioritizimi dhe menaxhimi i kërkesave
3. Siguria e Informacionit dhe Siguria Kibernetike	3. Komunikimet dhe Menaxhimi i Operacioneve
	4. Sistemi i Zbulimit dhe Mbrojtjes nga Ndërhyrja
4. Plani i Vazhdimësisë së Biznesit – Plani i Rikthimit nga Fatkeqësia[6]	5. Politika dhe plani i organizatës për Vazhdimësinë e Biznesit
5. Kontrollet e Aplikacionit	6. Kontrollet e hyrjes
	7. Kontrollet e përpunimit
	8. Kontrollet e të dhënave dalëse
	9. Kontrollet e sigurisë së aplikacionit

Fushëveprimi i këtij auditimi është Ministria e Punëve të Brendshme përkatësisht Agjencia për Shoqërinë e Informacionit dhe departamentet përgjegjëse për administrimin, menaxhimin dhe sigurinë e platformës e-Kosova. Gjithashtu, përfshihen njësitë përkatëse brenda Ministrisë e Financave, Punës dhe Transfereve përkatësisht departamentin për Tatimin në Pronë dhe Menaxhimin e Skemave Sociale të cilat administrojnë shërbimet përkatëse në platformë e-Kosova, siç janë shërbimet për tatimin në pronë dhe shtesat e fëmijëve. Auditimi ka mbuluar periudhën nga Janari i vitit 2024 deri në përfundim të auditimit, shqyrtuar funksionimin dhe ofrimin e këtyre shërbimeve përmes platformës **e-Kosova.** Për Sistemin e Tatimit në Pronë është duke u kryer një auditim tjetër i veçantë. Përveç kësaj ZKA në vitin 2023 ka publikuar raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit "Menaxhimi i Projekteve për Sistemet e Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit" ku një pjesë e platformës e-Kosova ishte përfshirë në auditim lidhur me zhvillimin dhe menaxhimin e projektit.

6 PVB & PRF – Plani për Vazhdimësinë e Biznesit & Plani për Rikthimin nga Fatkeqësia.

3 Gjetjet e auditimit

Platforma e-Kosova me ofrimin e rreth 230 shërbimeve elektronike ka arritur një përparim të konsiderueshëm në digjitalizimin e shërbimeve publike për qytetarët. Megjithatë, krahas zhvillimi, janë identifikuar disa mangësi që kërkojnë përmirësim, të cilat janë të paraqitura në këtë kapitull të raportit.

Gjetjet e auditimit ndërlidhen me politikat e kontraktimit, kërkesat për zhvillimin, kontrollet dhe administrimi i sigurisë së informacionit, planin për vazhdimësinë e biznesit dhe kontrollet e aplikacionit të platformës e-Kosova. Gjetjet janë të strukturuara sipas fushave dhe çështjeve të auditimit.



Figura 6. Struktura e çështjeve të auditimit të platformës e-Kosova

Pjesa e parë e paraqitur në kapitullin 3.1 mbulon çështjet e identifikuara e që kanë nevojë për përmirësim që lidhen me kontraktimin e sistemeve të informacionit (1).

Pjesa e dytë që është paraqitur në kapitullin 3.2 mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me zhvillimin dhe blerjen (2).

Pjesa e tretë që është paraqitur në kapitullin 3.3 mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me informacionin dhe sigurinë kibernetike (3-4).

Pjesa e katër që është paraqitur në kapitullin 3.4 mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me planin e vazhdimësisë së biznesit dhe planin e rikthimit nga fatkeqësia (5).

Pjesa e pestë që është paraqitur në kapitullin 3.5 mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me kontrollet e aplikacionit (6-10).

3.1 Politikat e kontraktimit

Organizatat duhet të kenë disa politika të cilat përcaktojnë se cilat funksione mund të kontraktohen dhe cilat funksione duhet të zhvillohen në ambientet e organizatës. Kontraktimi i shërbimeve në organizatë kërkon monitorim të afërt dhe është subjekt i kërkesave të privatësisë dhe sigurisë.[7]

Proceset kontraktuale, AShI i zhvillon sipas legjislacionit në fuqi, mirëpo ka mangësi në përfshirjen e sigurisë së informacionit gjatë kontraktimit.

Figura 7. Politikat e kontraktimit (Sistemi, politikat dhe siguria e informacionit)

1. Kontrata nuk adreson në mënyrë të mjaftueshme aspektet e sigurisë së informacionit

> *Kërkesat e sigurisë së organizatës duhet të jenë të theksuara nga kontraktori në mënyrë të përshtatshme. Marrëveshja me palët e jashtme që përfshin qasjen, përpunimin, komunikimin ose menaxhimin e informacionit ose strukturës së përpunimit të informacionit të organizatës, ose futjen e produkteve ose shërbimeve në sistemin për përpunimin e informacionit, është në përputhje me të gjitha kërkesat e duhura të sigurisë.*[8]

Analiza e kontratës dhe dokumentacionit përcjellës tregon se në përmbajtjen e kontratës nuk është adresuar pjesa e sigurisë së informacionit. Elementet e lidhura me sigurinë e informacionit, janë përmendur në dosjen e tenderit, por jo edhe në kontratën bazë.

Për më tepër, nuk janë përfshirë klauzola që përcaktojnë se si do të ruhet privatësia e të dhënave dhe cilët janë përgjegjësit në rast të kompromet imit të informacionit apo ndonjë incidenti të sigurisë.

[7] Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Politikat e kontraktimit.
[8] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontraktimi, Siguria.

Bazuar në dokumentacionin ekzistues dhe praktikën aktuale, fokusimi kryesor i marrëveshjes është aspekti teknik dhe funksional i sistemit. Ndërsa për shkak të mungesës së politikave të standardizuara, sigurisë së informacionit nuk është dhënë rëndësia e nevojshme në marrëveshje. Për kontraktim, AShI i referohet ligjit të prokurimit, në të cilin nuk është paraparë politikë e veçantë për sigurinë e informacionit, por është përshkruar vetëm në formë të përgjithshme.

Mungesa e trajtimit të sigurisë së informacionit dhe mangësitë në politikat e kontraktimit rrezikojnë sigurinë e sistemeve të kontraktuara dhe në rast të ndonjë incidenti të sigurisë së informacionit nuk ka mundësi të identifikohet përgjegjësia e palëve në kontratë, si dhe monitorimi dhe raportimi i incidentit.

3.2 Blerja dhe Zhvillimi

Zhvillimi, blerja dhe kontraktimi i jashtëm, sigurojnë se menaxhimi i kërkesave, analizimi dhe prioritizimi, mbështesin në vazhdimësi plotësimin e nevojave të përdoruesve në mënyrë optimale për zhvillimin e shërbimeve në platformën e-Kosova.[9]



Figura 8. Menaxhimi i kërkesave për zhvillim

2. *Mangësi në trajtimin e kërkesës emergjente për digjitalizimin e shërbimit për subvencioni e librave në platformën e-Kosova dhe shërbimi nuk është plotësisht elektronik*

AShI duhet të analizon, përcakton prioritetet dhe menaxhon kërkesat për të siguruar që nevojat e përdoruesve të plotësohen në mënyrë optimale dhe me kosto efektive.[10] *Transaksionet e aplikacionit ekzekutohen në përputhje me sjelljen e pritur.* [11]

AShI për zhvillimin e shërbimeve elektronike në platformën e-Kosova, përveç shërbimeve të planifikuara, gjithashtu zhvillon shërbime me kërkesa emergjente apo të përshpejtuara të cilat trajtohen jashtë procedurave standarde dhe dokumentit planifikues.

Në vitin 2023 është zhvilluar në formë të përshpejtuar "Shërbimi për subvencionimin e librave me kërkesë nga MASHTI. Kjo kërkesë u bë pa specifikime teknike dhe jashtë procedurave të zakonshme planifikuese. Për më tepër, në atë kohë, AShI nuk kishte kontratë aktive për mirëmbajtje dhe

[9] Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm.
[10] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit –Blerja dhe zhvillimi.
[11] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e përpunimit.

zhvillimin e platformës e-Kosova prandaj mungonin dokumentet dhe analizat e nevojshme për të siguruar cilësinë e këtij shërbimi.

Detajet teknike dhe kriteret për këtë shërbim u diskutuan vetëm në takime verbale dhe nuk u dokumentuan. Edhe në vitin 2024, ky shërbim u aktivizua në mënyrë të menjëhershme përmes një kërkese pa ndonjë ndryshim nga viti i kaluar.

AShI, nuk ndjek procedura të standardizuara për kërkesat urgjente, sepse nuk ka një proces të shkruar për trajtimin e tyre. Ndërsa kërkesat për zhvillimin e shërbimit kanë ardhur pa u mbështetur në analiza teknike nga stafi profesional i ministrisë kërkuese, në këtë rast nga MAShTI.

Pa analiza paraprake dhe kritere të qarta, shërbimi i digjitalizimit mund të mos i përmbushë nevojat e qytetarëve. Në këtë rast kanë përfituar persona që nuk ju takon apo nuk kualifikoheshin për subvencionin e librave.

Për më tepër shërbimi për subvencionimin e librave në platformën e-Kosova nuk është plotësisht elektronik. Çdo informatë tjetër pas aplikimit të qytetarit trajtohet jashtë kësaj platforme, në mënyrë manuale nga institucioni fundor (MAShTI).

Mungesa e analizave për zhvillimin e një shërbimi dhe mungesa e bashkëpunimit adekuat ndërmjet AShI si zbatues dhe MAShTI si njësi kërkuese dhe përcaktues i kritereve ka bërë që zhvillimi i shërbimit elektronik të jetë jo efektiv dhe nuk është arritur digjitalizimi i plotë i tij duke mos ofruar informacion të plotë dhe të saktë.

Kjo mënyrë e organizimit dhe vendosjes së shërbimeve ndikon negativisht në efektivitetin, sigurinë dhe besueshmërinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët si dhe në avancimin e ndërlidhjen e kësaj platforme me sisteme tjera.

Shënim: Financimi/subvencioni i librave shkollor është audituar nga ekipi i auditimit financiar dhe gjetjet lidhur me këtë çështje përfshirë ndikimin financiar janë paraqitur në Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2024.

3.3 Siguria e Informacionit

Siguria e informacionit është një nga aspektet themelore të qeverisjes së TI-së për të siguruar disponueshmërinë, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave. Për menaxhim më të mirë të sigurisë së informacionit, institucioni, duhet të krijojë mekanizma që të mundësojë menaxhimin e rreziqeve të lidhura me sigurinë, marrjen e masave të duhura dhe garancinë se informacioni është i disponueshëm, i përdorshëm, i plotë dhe i pa kompromentuar.[12]



Figura 9. Parimet e sigurisë së informacionit

3. AShI funksionon pa politikë të sigurisë së informacionit të përditësuar dhe miratuar.

AShI duhet të sigurohet që ekzistojnë politika të përcaktuara për sigurinë e informacionit dhe ato janë të miratuara, të komunikuara dhe të zbatuara brenda organizatës. Politikat duhet të rishikohen në mënyrë të rregullt ose kur ka ndryshime të rëndësishme në organizatë, teknologji apo ligje të aplikueshme.[13] Politikat dhe procedurat duhet të formojnë një mjedis të qëndrueshëm menaxherial për komunikimet e brendshme dhe të jashtme.[14]

AShI në vitin 2010 kishte hartuar politikat e sigurisë së informacionit të cilat në atë kohë përmbushnin kërkesat e organizatës, me të cilat politika kishte funksionuar deri në vitin 2021. Këto politika u shfuqizuan me vendim të Qeverisë. Mirëpo, ata ende vazhdojnë t'i përdorin si praktikë politikat e shfuqizuara, në mungesë të përditësimit të tyre. Ata nuk kanë hartuar as procedura për sigurinë e informacionit dhe funksionojnë pa ndonjë mbështetje rregullative. Prandaj, zhvillimet që kanë ndodhur në AShI dhe në fushën e sigurisë së informacionit në nivel global nga viti 2010 deri në vitin 2021 nuk janë pasqyruar në politikat përkatëse për sigurinë e informacionit. Andaj, AShI nuk ka politikë të miratuar dhe në fuqi për sigurinë e informacionit. Megjithëse, mungojnë politika dhe procedura, Zyra e Kryeministrit dhe MPB, me mbështetjen e institucioneve dhe akterëve të jashtëm, kanë hartuar Strategjinë për Qeverisje Elektronike 2023–2027. Qëllimi i saj është të përshpejtojë e-qeverisjen në Kosovë përmes përmirësimit të sistemit ekzistues, shtimit të funksioneve të reja dhe përdorimit të praktikave dhe teknologjive moderne. Përveç kësaj AShI ka

[12] Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Siguria e Informacionit.
[13] ISO/IEC 27002:2022 – Politikat për Sigurinë e Informacionit.
[14] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit - Informacioni dhe Siguria Kibernetike, Komunikimet dhe Menaxhimi i Operacioneve.

marr masa mbrojtëse aplikimet teknike dhe konfigurimet në sistemet e informacionit për mbrojtjen e sigurisë nga kërcënimet kibernetike.

AShI ishte në pritje të sigurimit të bazës ligjore dhe në fund të vitit 2024 është miratuar Ligji për Krijimin e Bazës Ligjore për Nxjerrjen e Akteve Nënligjore nga Qeveria dhe Ministrat[15] në të cilin parashihet edhe nxjerrja e Rregullores për sigurinë e informacionit .

Politika e sigurisë e shfuqizuar dhe e pa përditësuar, si dhe mungesa e udhëzimeve të reja mbi praktikat e sigurisë, lë punonjësit të painformuar dhe të paaftë të mbrojnë organizatën në mënyrë efektive dhe e bën më të cenueshme organizatën ndaj sulmeve kibernetike dhe strategjinë dhe çdo iniciativë tjetër për sigurinë kibernetike më pak efektive.

4. AShI ka mangësi në kontrollet e brendshme

Organizata duhet të sigurojë që ndërhyrjet janë zbuluar dhe do të zbulohen dhe luftohen. [16] *Organizata duhet të sigurojë që ekzistojnë masa të përshtatshme për të parandaluar, zbuluar dhe rikuperuar nga kërcënimet e kodit të dëmshëm përmes politikave, kontrolleve teknike dhe ndërgjegjësimit të përdoruesve.* [17] *Agjencia e Shoqërisë së Informacionit duhet të kujdeset për sigurinë dhe mbrojtjen e infrastrukturës elektronike dhe të dhënave dhe koordinon aktivitetet për sigurinë e shërbimeve të TI-së.* [18]

Aplikimet teknike të sigurisë nga AShI zbatohen në nivelin e pajisjeve të dedikuara për mbrojtje, të cilat janë të konfiguruara për të siguruar mbrojtje të avancuar ndaj ndërhyrjeve. Po ashtu, realizon raporte për incidentet e sigurisë kibernetike në infrastrukturën e TI-së së AShI-së në formë të shkruar. Megjithatë, AShI, nuk ka një procedurë të shkruar për parandalimin e ndërhyrjeve.

Përveç mungesës së procedurave, nuk ekzistojnë as dokumente që saktësojnë se cilat porte të serverëve ose platformave lejohen apo ndalohen për qasje. Edhe pse qasja në porte përcaktohet sipas kërkesave teknike dhe softuerike të institucioneve.

Po ashtu, ata nuk realizojnë dokumentim specifik për mbrojtjen nga ndërhyrjet, mirëpo informacionet për nivelin e qasjeve ruhen në pajisjet përkatëse që menaxhojnë sigurinë. E njëjta praktikë realizohet edhe për platformën e-Kosova.

Për më tepër, ndërgjegjësimi i stafit lidhur me sigurinë e informacionit është i ulët, AShI nuk ka realizuar fushata ndërgjegjësuese për sigurinë e informacionit, as nuk ka një plan dhe resurse të ndara për trajnimin e burimeve njerëzore lidhur me këtë pjesë. Mirëpo, AShI aktivitetin ndërgjegjësues për sigurinë e informacionit e ka adresuar në mënyrë reaktive përmes njoftimeve dhe email-eve informuese, sidomos në rastet kur janë evidentuar tentativa phishing (mashtrim elektronik që përdoret në kategorinë e sulmeve kibernetike për përfitimin e informacionit të ndjeshëm) apo incidente të tjera të sigurisë. Në këto raste, janë ndërmarrë veprime të menjëhershme për të informuar stafin dhe për të minimizuar rrezikun. Gjithashtu, Instituti Kosovar për Administratë Publike (IKAP) është përgjegjës për ofrimin e trajnimeve, duke përfshirë edhe fushën

[15] Ligji Nr. 08/L-276 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve të Veçanta për Krijimin e Bazës Ligjore për Nxjerrjen e Akteve Nënligjore nga Qeveria dhe Ministrat.

[16] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Informacioni dhe Siguria Kibernetike, Sistemi i Zbulimit dhe Mbrojtjes nga Ndërhyrja.

[17] ISO 27001 – Kriteret për mbrojtjen ndaj kodit të dëmshëm (malware).

[18] Rregullore (Qrk) Nr. 02/2016 për Koordinim në mes të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Strukturave Organizative/ Zyrtarëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Institucionet e Republikës së Kosovës.

e sigurisë së informacionit e cila është në kuadër të programeve të veta për ngritjen e kapaciteteve të administratës publike.

Këto mangësi në kontrollet e brendshme për sigurinë e informacionit janë edhe si shkak i mungesës së resurseve të AShI-së, prandaj të gjitha masat e sigurisë i ka orientuar në aplikimet teknike të sigurisë.

Mungesa e procedurave për mbrojtjen ndaj ndërhyrjeve dhe kontrollimin e qasjes në sistemin e informacionit rrit rrezikun e keqpërdorimit të qasjeve dhe përdorimit të qasjeve të paautorizuara, si dhe mos evidentimin e ndërhyrjeve në kohë dhe mos identifikim të përgjegjësisë në rastet e incidenteve të sigurisë së informacionit.

3.4 Plani i Vazhdimësisë së Biznesit – Plani i Rikthimit nga Fatkeqësia

Organizata duhet të ketë edhe një plan të vazhdimësisë për të siguruar edhe vazhdimësinë e ofruesit të shërbimit për veprimtarinë e tyre ose të marrë përsipër këtë nga një kompani tjetër.
Nëse rimëkëmbja nga fatkeqësitë të një fushe kritike funksionale rrezikohet, do të rrezikohet vazhdimësia e biznesit (veprimtarisë).[19]

Figura 10. Vazhdimësia e biznesit

5. AShI nuk ka politikë efektive për vazhdimësinë e biznesit

Organizata duhet të ketë politikat organizative mbi vazhdimësinë e biznesit, të cilat përmbajnë detyrat dhe përgjegjësitë, qëllimin, kriteret e alokimit të burimeve/parimet, kërkesat për trajnim, orar të mirëmbajtjes, orarin e testimeve, planet backup (ruajtjes së kopjeve rezervë), si dhe nivelet e aprovimit.[20] *Organizata duhet*

[19] Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, PVB – PRF.
[20] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – PVB-PRF, Politika dhe plani i organizatës për Vazhdimësinë e Biznesit.

të ketë planin për të mbajtur dhe rikthyer operacionet e biznesit, për të siguruar disponueshmërinë e informacionit brenda nivelit të kërkuar dhe në kohën e përcaktuar pas një ndërprerjeje ose dështimi të proceseve të biznesit. [21] *Kopjet rezervë të aplikacioneve dhe bazave të të dhënave bëhen konform procedurave standarde të operimit dhe duhet të ruhen në konfidencialitet në bazë të ligjit.* [22]

AShI, nuk ka politika dhe procedura për vazhdimësinë e biznesit dhe rikthimin nga fatkeqësia, ata bazohen në udhëzimin administrativ për menaxhimin e sigurisë së informacionit të vitit 2010 i cili është i shfuqizuar për realizimin e kopjes rezervë (backup). Për më tepër ata nuk kanë një qendër tjetër për vazhdimësinë e biznesit dhe rikthim nga fatkeqësia, apo edhe një infrastrukturë tjetër të njëjtë harduerike për testimin dhe vënien në funksion të kopjes rezervë në rast nevoje. AShI, në vazhdimësi kishte bërë përpjekje për krijimin e një qendre për vazhdimësinë e biznesit duke ndërmarr edhe veprime sidomos viteve të fundit. Deri në zgjidhjen e përhershme, ata realizojnë krijimin e kopjes rezervë (backup) në baza të rregullta për infrastrukturën ku është e vendosur platforma e-Kosova ndërsa mund ta rikthejnë në infrastrukturën primare që është në përdorim si dhe testimi i rregullt i kopjes rezervë nuk mund të realizohet.

Shkaku për mungesën e politikave dhe procedurave për vazhdimësinë e biznesit është mungesa e një Qendre për Vazhdimësinë e Biznesit dhe Rikthim nga Fatkeqësia dhe mungesa e infrastrukturës. Ndërsa mungesa e kësaj qendre është si pasojë e mungesës së menaxhimit të resurseve bazuar në rrezik si rezultat i një qeverisje jo të mirë të TI-së në AShI. Mirëpo këtë vit është nënshkruar kontrata për sigurimin e infrastrukturës për të mundësuar realizimin e një zgjidhje për vazhdimësinë e biznesit dhe është krijuar baza ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore.

Në rast fatkeqësie, ekziston rreziku i konsiderueshëm që të dëmtohen sistemet, të humbin të dhënat dhe si pasojë, operacionet e këtyre platformave shtetërore, përfshirë edhe e-Kosovën të dështojnë se kryeri/funksionuari.

[21] ISO 27001 – Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit.
[22] Rregullore (Qrk) Nr. 02/2016 për Koordinim në mes të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Strukturave Organizative/ Zyrtarëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Institucionet e Republikës së Kosovës.

3.5 Kontrollet e aplikacionit

Kontrollet e aplikacionit janë: kontrolli mbi funksionin e hyrjes, të përpunimit, të daljes dhe sigurisë. Ato përfshijnë metoda për të siguruar që: vetëm të dhëna të plota, të sakta, të vlefshme dhe të besueshme vendosen dhe azhurnohen në një sistem të informacionit, përpunimi realizon detyrën e saktë dhe rezultati i përpunimit plotëson pritjet dhe të dhënat ruhen.[23]



6. Mungesa e aplikimit të kriterit kufizues në kontrollet hyrëse në platformën e-Kosova për shërbimin shtesat e fëmijëve

Rregullat e vlefshmërisë duhet të jenë të mirë-hartuara, dhe të zbatuara në ndërveprimin e hyrjeve (inputit); duhet të dokumentohen metoda të ndryshme për futjen e të dhënave; të dhëna jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; kriteret e vlefshmërisë përditësohen në mënyrën e duhur dhe të autorizuar; duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi në rast të mundësisë së kontrolleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrolle për hyrjet e aplikacionit.[24] *Agjencia e përkrah dhe koordinon aktivitetet mes IRK-ve që bazat e të dhënave/regjistrat e rëndësishëm të ndërveprojnë në mes tyre.* [25]

Në platformën elektronike e-Kosova është vendosur shërbimi "Shtesat për Fëmijë" i cili menaxhohet nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT), bazuar në vendimin e Qeverisë në vitin 2024. Për përfitimin e kësaj shtese janë vendosur kriteri i moshës dhe numrit të fëmijëve, ku për familjet që kanë deri në dy fëmijë 0-16 vjeç, mbështetja financiare do të jetë 20 euro në muaj për secilin fëmijë dhe për familjet që kanë tre apo më shumë fëmijë të moshës 0-16 vjeç, mbështetja do të jetë 30 euro në muaj për secilin fëmijë. Poashtu në këtë vendim është përcaktuar që mbështetjen financiare ta përfitojnë të gjithë fëmijët deri në moshën 16 vjeçare që kanë shtetësinë e Kosovës dhe që janë banorë rezident në Republikën e Kosovës. Mirëpo ky kriter nuk është i aplikuar në platformën e-Kosova, për të parandaluar njëkohësisht përfitime nga banorët jo rezident, prandaj, aktualisht sistemi lejon teknikisht aplikimin dhe përfitimin e mbështetjes financiare edhe nga fëmijët që nuk janë banorë rezidentë dhe që jetojnë jashtë Republikës së Kosovës.

Mungesën e aplikimit së këtij kriteri si kontroll kufizuese në sistem, në platformën e-Kosova dhe i cili është i përcaktuar me vendimin nr. 55-5/2024 i cili i obligon të gjithë qytetarët e lindur jashtë Kosovës apo që janë vonuar më shumë se tre muaj të aplikojnë për shtesë të i nënshtrohen procesit

[23] Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Kontrollet e aplikacionit.
[24] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.
[25] Rregullore (Qrk) Nr. 02/2016 për Koordinim në mes të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Strukturave Organizative/ Zyrtarëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Institucionet e Republikës së Kosovës.

të verifikimit në platformën e-Kosova, MFPT e menaxhon në mënyrë manuale që realizohet në formë fizike përmes postës.

Platforma e-Kosova nuk e zbaton kriterin e rezidencës si kontroll kufizuese e sistemit sepse nuk ka të dhëna të sakta për vendbanimin e qytetarëve jashtë Kosovës dhe mungon ndërlidhja funksionale me sistemet që mund ta verifikojnë këtë informacion. AShI ka theksuar se nuk ka ndonjë mekanizëm për të verifikuar vendbanimin, pasi nuk ka qasje në të dhëna të sakta nga regjistri i ARC-së.

Shërbimi elektronik për shtesat e fëmijëve në platformën e-Kosova lejon mundësinë e ofrimit të shtesave për fëmijë edhe për qytetarë të cilëve nuk i takon ky shërbim. Kjo pasi nuk ka të vendosura kontrolle të mjaftueshme hyrëse në aplikacion në mungesë të kritereve në platformë dhe mekanizmit për verifikimin e rezidencës. Por ky kontroll realizohet në formë manuale nga MFPT.

7. Moduli i pagesës në e-Kosova lejon realizimin e pagesave të dyfishta pa njoftim për qytetarin.

Transaksionet e aplikacionit ekzekutohen në përputhje me sjelljen e pritur.[26] *Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në mënyrë të kontrolluar dhe të besueshme, duke siguruar që ato të përputhen me rregullat e biznesit, parametrat e konfigurimit dhe skenarët e parashikuar të përpunimit.*[27]

Për shërbimet elektronike që ofrohen në platformën e-Kosova qytetarët mund të realizojnë pagesat përmes modulit për pagesë në këtë platformë. Ky modul është i ndërlidhur me platformat bankare dhe realizon pagesën në kohë reale dhe të sigurt, sigurinë e ka në nivelin e mekanizmave të sigurisë bankare. Mirëpo, gjatë verifikimit të 120,233 transaksioneve/mostrave për pagesa të ndryshme të realizuara nga qytetarët përmes platformës e-Kosova në këtë modul, kemi hasur 1,112 transaksione të pagesave të duplifikuara, për shërbime të ndryshme siç janë: gjobat e policisë, Uji për KRU Prishtina, Certifikata mbi të drejtat në pronën e paluajtshme individuale, Certifikata mbi të drejtat në pronën e paluajtshme biznesore, Mbeturinat në Komunën e Prishtinës, KESCO, HidroDrini, Kadastri, Tatimi në Pronë. Për analiza të mëtejme janë përzgjedhur mostrat e shërbimeve të Policisë së Kosovës dhe Komunës së Prishtinës. Nga të cilat kemi marr edhe dëshmi shtesë konfirmimin e ekzistimit të pagesave të dyfishta, ankesat e qytetarëve dhe kërkesat për rimbursim.

Shkaku për pagesat e dyfishta në platformën e-Kosova është mos fshirja e borxhit në momentin e pagesës në kohë reale në platformën e-Kosova dhe lejimi i ekzekutimit të pagesës së njëjtë për disa herë me radhë pa ndonjë njoftim paraprak për qytetarin dhe pa konfirmim për ekzekutimin e pagesës së parë. Si rezultat qytetarët kanë paguar më shumë se njëherë pagesën e njëjtë për shërbimet në platformën e-Kosova.

8. Procesi i aplikimit për shtesa të fëmijëve mes dy sistemeve nuk është i sinkronizuar e digjitalizuar plotësisht.

Organizata duhet të ketë të hartuara procedurat për të siguruar se plotësia dhe saktësia rezultateve të aplikacioneve është vlerësuar përpara përdorimit të rezultatit nga përpunimi i mëtejshëm, përfshirë përpunimin e përdoruesve final dhe kontrollet e plotësisë dhe të saktësisë të jenë efektive.[28]

[26] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e përpunimit.
[27] Përdorimi i udhëzimeve të COBIT (sidomos DSS05 dhe BAI09) për kontrollin e proceseve dhe sigurimin e besueshmërisë së përpunimit të transaksioneve.
[28] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e të dhënave dalëse.

Në platformën elektronike e-Kosova bëhet vetëm aplikimi për shtesa të fëmijëve në mënyrë të digjitalizuar. MFPT këto aplikime i pranon në sistemin e saj në baza mujore përmes një ndërlidhje manuale nga zyrtari i TI-së në MFPT, i cili e realizon atë duke thirrur të gjitha aplikimet për çdo muaj dhe duke sinkronizuar ato në sistemin e MFPT-së, Sistemi i Informacionit të Departamentit për Politika Sociale dhe Familje (SIDPSF). Por, ndërlidhja nuk ka mjaftueshëm kontrolle, dhe gjatë sinkronizimit të të dhënave kemi raste të duplifikimit për shtesa të fëmijëve. Këto parandalohen dhe identifikohen përmes sistemit të MFPT-së, SIDPSF dhe filtrohen ato lista nga duplifikimet. Pra, çdo informatë pas aplikimit të qytetarit trajtohet jashtë platformës e-Kosova, deri në fazën e aprovimit dhe refuzimit që realizohet nga zyrtari përgjegjës i MFPT-së në këtë platformë.

AShI nuk është e njoftuar që ka duplifikime pasi që komunikimi ndërmjet sistemeve nuk është plotësisht i digjitalizuar, duke rezultuar në shkëputje mes tyre. Ndërlidhja është e realizuar me importim të të dhënave përmes fajllit sinkronizues, në mungesë të servisit për ndërlidhje në sistemin SIDPSF. Në AShI, zyrtarët kanë theksuar se nuk ka asnjë aplikim të dyfishtë nga e-Kosova dhe këtë e kemi verifikuar gjatë testimeve në aplikacion, si dhe është vërtetuar edhe pas verifikimit të mostrave të pranuara nga baza e të dhënave të e-Kosovës, se një gjë e tillë nuk lejohet. Por kjo ndodhë gjatë procesit të sinkronizimit të të dhënave mes dy sistemeve.

Platforma e-Kosova dhe sistemi SIDPSF nuk kanë ndërlidhje të plotë e në kohë reale mes vete, pasi ka shkëputje në komunikim. Si pasojë e kësaj, ndodhin duplifikime të aplikimeve për shtesat e fëmijëve.

9. Shërbimi i tatimit në pronë nuk e shfaq gjendjen reale të faturës pas pagesës.

Organizata duhet të ketë të hartuara procedurat për të siguruar se plotësia dhe saktësia e rezultateve të aplikacioneve është vlerësuar përpara përdorimit të rezultatit nga përpunimi i mëtejshëm, përfshirë përpunimin e përdoruesve final dhe kontrollet e plotësisë dhe të saktësisë të jenë efektive. [29]

Platforma e-Kosova është e ndërlidhur me sistemin e tatimit në pronë (si sistem fundor) nga i cili merr të dhënat për prezantimin e pasqyrave të borxheve dhe në rast të pagesës, ajo pagesë përcjellët në sistemin e tatimit në pronë. Mirëpo, sistemi i tatimit në pronë nuk i shfrytëzon të dhënat e pagesës për ta pasqyruar faturën e tatimit në pronë. Pra kur qytetari bën pagesën për tatimin në pronë, sistemi i tatimit në pronë nuk e përdorë atë vlerë të pranuar nga e-Kosova, por pret të dhënat që dërgohen nga Thesari për të hyrat e pranuara në llogarinë e Thesarit.

Prandaj edhe pse pagesa është kryer dhe në platformë figuron si e përfunduar, fatura për pagesë mbetet e njëjtë dhe ende figuron në sistem si borxh duke mundësuar që pagesa e njëjtë të bëhet përsëri. Kjo qëndron deri në pranimin e informatës nga Thesari dhe kjo po ndodh në vazhdimësi.

Për më tepër, në rastet kur qytetarët bëjnë pagesën ditën e fundit të afatit pas orarit të punës, ajo pagesë në sistemin e tatimit në pronë i regjistrohet disa ditë pas pranimit të saj si e hyrë në llogarinë e Thesarit, duke injoruar informatën e datës së saktë të pagesës që dërgohet nga platforma e-Kosova, edhe pse përkufizimi i nenit për pagesën është përcaktuar me ligjin e tatimit në pronë. Si pasojë qytetari ndëshkohet me aplikimin e interesit dhe ndëshkimit. Kjo krijon shpenzime shtesë dhe detyron qytetarin të bëjë ankesa në formë fizike për të dëshmuar kohën e pagesës brenda afatit ligjor.

[29] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e të dhënave dalëse.

MFPT këtë e arsyeton me rregulloren e të hyrave në Thesar dhe nuk merrë parasysh nenin e ligjit për tatimin në pronë lidhur me pagesën dhe afatin e pagesës.

10. AShI ka mungesë të politikave dhe procedurave për menaxhimin dhe monitorimin e gjurmëve të auditimit

Duhet të ekzistojnë gjurmë të mjaftueshme të auditimit që kapin modifikimet, regjistrimet e autorizuara të transaksioneve kritike; gjurmët e auditimit rishikohen periodikisht për të monitoruar aktivitetet jonormale; gjurmët e auditimit mirëmbahen dhe ruhen në mënyrën e duhur; numra unikë dhe sekuencialë, ose identifikues duhet të jenë të përcaktuar për çdo transaksion.[30]

Në platformën e-Kosova ruhen gjurmët audituese në kuadër të sistemit dhe në kuadër të bazës së të dhënave. Gjurmët audituese janë të mbrojtura nga modifikimet dhe qasjet për monitorimin e tyre janë të ndara sipas standardeve për ruajtjen e sigurisë së informacionit. Nga mostrat e pranuara mbi 2 milionë rekorde për gjurmueshmërinë dhe të analizuara përmes veglave të punës për auditim (CATs) kemi vlerësuar se numrat unikë dhe sekuencial identifikues të gjurmueshmërisë ishin të pa modifikuar dhe të mbrojtur siç duhet.

Mirëpo, AShI edhe pse ka krijuar gjurmë audituese për platformën e-Kosova dhe ka ndarë qasjet në gjurmët e auditimit prej qasjeve të përdoruesve, ata nuk arrijnë të bëjnë monitorimin e rregullt të gjurmëve të auditimit, nuk kanë politikë apo procedurë për menaxhimin dhe monitorimin e gjurmëve të auditimit që do të përcaktonin kohën dhe detyrat për zyrtarët përgjegjës për monitorimin e gjurmëve të auditimit. Por ata monitorimin e realizojnë vetëm në rast të aktiviteteve të dyshimta dhe raportimeve për incidente të mundshme.

Mungesa e resurseve e në veçanti e burimeve njerëzore i bënë të pamundur AShI-së monitorimin e gjurmëve të auditimit në baza të rregullta, ndërsa sa i përket procedurave ato ishin pjesë e politikës së sigurisë e cila tani është e shfuqizuar.

Mungesa e një politike dhe procedure të qartë për monitorimin dhe rishikimin periodik të gjurmëve të auditimit, si dhe mos monitorimi i rregullt i tyre nga ASHI për platformën e-Kosova, kufizon aftësinë dhe rrit rrezikun për të identifikuar në kohë veprimtari të pasakta ose të paautorizuara. Edhe pse nuk është konstatuar ndonjë incident konkret gjatë periudhës së auditimit. Kjo cenon integritetin, besueshmërinë dhe sigurinë e sistemit të informacionit dhe mund të çojë në humbje të të dhënave, ndërhyrje të paautorizuara, apo përgjegjësi institucionale për mosveprim.

[30] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e sigurisë së aplikacionit.

4 Konkluzionet

Platforma e-Kosova ka arritur hapa të rëndësishëm drejt digjitalizimit të shërbimeve publike, duke ofruar një mjet të rëndësishëm për lehtësimin e qasjes së qytetarëve dhe institucioneve në procese të ndryshme administrative, duke përmirësuar edhe transparencën dhe efikasitetin. Megjithatë, ende ka sfida në integrimin e sistemeve, sigurinë e informacionit, kontrollin e të dhënave që ndikon në besueshmërinë e tyre si dhe vazhdimësinë e biznesit e cila ndikon në sigurinë e të dhënave.

Kontraktimi
Kontrata nuk përfshin mjaftueshëm kërkesat dhe masat për sigurinë e informacionit, siç janë: klauzola për mbrojtjen e të dhënave dhe përgjegjësitë e palëve në projekt në raste incidentesh. Fokusi kontratës është tek aspektet teknike, ndërsa siguria është lënë pas edhe për shkak të mungesës së politikave dhe legjislacionit specifik, duke e lënë sigurinë e sistemit të informacionit të pa adresuar mjaftueshëm.

Blerja dhe zhvillimi
AShI trajton kërkesat emergjente për shërbime elektronike pa dokumentim dhe planifikim të duhur. Shërbimi për subvencionimin e librave u zhvillua pa kontratë aktive dhe pa kritere teknike të qarta, pa ndjekur procedura standarde. Kjo ka sjellë shërbime joefikase dhe rrezik për keqmenaxhim të përfitimeve.

Siguria e informacionit dhe siguria kibernetike
AShI vazhdon të funksionojë me politika të sigurisë së informacionit të shfuqizuara dhe të pa përditësuara, pa procedura të shkruara që përcaktojnë mënyrën e menaxhimit të qasjes dhe parandalimit të ndërhyrjeve. Kjo situatë lë punonjësit të painformuar dhe organizatën më të cenueshme ndaj sulmeve kibernetike, duke ndikuar negativisht në efektivitetin e masave dhe strategjive të sigurisë.

Megjithatë, AShI ka zbatuar masa teknike mbrojtëse dhe mekanizma të avancuar për parandalimin e ndërhyrjeve, por mungesa e dokumentimit specifik dhe e ndërgjegjësimit të stafit për sigurinë e informacionit rrit rrezikun e keqpërdorimeve, qasjeve të paautorizuara dhe mos identifikimin në kohë të incidenteve të sigurisë.

Plani i Vazhdimësisë së Biznesit – Plani i Rikthimit nga Fatkeqësia
AShI nuk ka një politikë efektive për vazhdimësinë e biznesit dhe rikthimin nga fatkeqësitë, pasi mungojnë procedurat dhe infrastruktura e nevojshme, përfshirë një qendër dytësore funksionale. Me gjithë përpjekjet për krijimin e kësaj qendre dhe realizimin e kopjeve rezervë, nuk mjaftojnë për të siguruar rikthim të shpejtë dhe të sigurt të operacioneve në rast emergjence, duke rrezikuar funksionimin e sistemeve kritike shtetërore.

Kontrollet e aplikacionit

Në platformën e-Kosova janë identifikuar mangësi në kontrollin e aplikacionit, si kontrolli i hyrjes, integrimi i sistemeve dhe siguria e informacionit. Mungesa e kontrolleve hyrëse dhe verifikimit automatik të kritereve ka krijuar mundësi të përfitimeve pa kritere, veçanërisht në shërbimet "Shtesat për fëmijë" dhe "Subvencionimi i librave shkollorë", ku në shërbimin "Subvencionimi i librave" janë evidentuar raste konkrete. Platforma gjithashtu nuk mundëson digjitalizim të plotë

dhe ka probleme me sinkronizimin në kohë reale të të dhënave mes sistemeve. Si rezultat, janë shënuar aplikime të dyfishta dhe pagesa të përsëritura nga qytetarët, duke dëmtuar ata dhe besueshmërinë e platformës. Mungesa e politikave dhe procedurave për monitorim dhe menaxhim të gjurmëve të auditimit, e kombinuar me mungesën e stafit të mjaftueshëm, rrit rrezikun për cenim të integritetit, sigurisë dhe funksionalitetit të sistemit. Këto probleme tregojnë nevojën urgjente për përmirësim të kontrolleve, integrimit, digjitalizimit dhe sigurisë së platformës, në mënyrë që të garantohet ofrimi i besueshëm dhe efektiv i shërbimeve publike elektronike.

5 Rekomandimet

Rekomandojmë Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit që:

1. **Politikat e kontraktimit**, MPB-ja dhe AShI-ja para se të iniciojë zhvillimin e çdo projekti të teknologjisë së informacionit, duhet që në të gjitha kontratat e zhvilluara të teknologjisë së informacionit të adresojë kërkesat e sigurisë së informacionit me të gjitha elementet e sajë, duke e përfshirë edhe ruajtjen e privatësisë së të dhënave dhe përcaktimin e përgjegjësive të palëve në projekt bazuar në politikat standarde të sigurisë së informacionit.

2. **Menaxhimi i kërkesave,** AShI për zhvillimin e kërkesave "emergjente" duhet të hartoj procedurë që udhëzon trajtimin e kërkesës dhe dokumentimin e saj, për të analizuar dhe zhvilluar të gjitha elementet e nevojshme të zhvillimit lidhur me saktësinë, plotësin dhe sigurinë e informacionit.

   2.1. Kontrollet e përpunimit në aplikacion për subvencionin e librave AShI dhe MAShTI në koordinim, për aktivizimin e shërbimit për subvencionimin e librave duhet të hartoj kërkesat me specifikat teknike dhe të përcaktoj kriteret e nevojshme që kufizojnë aplikimet vetëm për qytetarët që kanë të drejtë të marrin subvencion dhe të digjitalizoj komplet procesin deri në aprovimin/refuzimin dhe pranimin e subvencionit përmes platformës e-Kosova, duke përcaktuar edhe rolet për aprovim, refuzim dhe monitorim të shërbimit.

3. **Politika e sigurisë së informacionit,** MPB-ja dhe AShI-ja të përditësoj politikat dhe procedurat për të mbrojtur sigurinë e informacionit.

4. **Kontrollet e brendshme për sigurinë e informacionit,** AShI-ja të sigurojë procedurat për parandalimin e ndërhyerjeve dhe menaxhimin e qasjeve në portet e caktuara të platformave dhe infrastrukturës serverike.

   4.1. AShI të realizojë dokumentim të procedurave për mbrojtje ndaj ndërhyrjeve.
   4.2. AShI të sigurojë një plan për ndërgjegjësimin e burimeve njerëzore lidhur me sigurinë e informacionit dhe të fokusojë resurset e saj në trajnimin dhe vetëdijësimin e stafit lidhur me sigurinë e informacionit.

5. **Plani për vazhdimësinë e biznesit,** Menaxhmenti i AShI-së duhet menjëherë të ri-vlerësoj rreziqet dhe të orientoj resurset krahas zhvillimeve të tjera edhe në vazhdimësinë e biznesit, duke filluar me krijimin e një Qendre për Vazhdimësinë e Biznesit dhe Rikthim nga Fatkeqësia.
   5.1. AShI duhet të hartoj, miratoj dhe zbatoj politika, procedura dhe planin për vazhdimësinë e biznesit.

6. **Kontrollet hyrëse në aplikacion për shërbimin shtesat e fëmijëve,** AShI të ndërlidh shërbimin për shtesat e fëmijëve me regjistrat e qytetarëve për rezidencën dhe të mundësoj realizimin e shërbimit plotësisht në formë elektronike. ASHI, në platformën e-

Kosova, duhet të aplikojë mekanizmin më të përshtatshëm për identifikimin e banorëve rezidentë të Kosovës, duke shfrytëzuar të dhënat nga të gjitha institucionet relevante të vendit.

7. **Kontrollet e aplikacionit për modulin e pagesës,** AShI të përditësoj pasqyrat e borxheve për shërbimet e qytetarëve në e-Kosova në kohë reale dhe të vendos mekanizma kontrolli në modulin e pagesës që njoftojnë qytetarin për realizimin e pagesës duke e shmangur pagesën e dyfishtë.

8. **Kontrollet dalëse në aplikacion për shërbimin shtesat e fëmijëve,** AShI dhe MFPT të realizojnë kontrollet e duhura për ndërlidhjen në mes sistemeve e-Kosova dhe SIDPSF dhe të zbatojnë një ndërlidhje të sigurt që nuk lejon duplifikimin e të dhënave duke realizuar digjitalizimin e plotë të procesit përmes e-Kosovës. Të dhënat që dërgohen nga platforma duhet të trajtohen nëpërmjet sistemit dhe jo në mënyrë manuale.

9. **Kontrollet dalëse në aplikacion për shërbimin e tatimit në pronë,** MFPT të shfrytëzoj të dhënat e pagesës së qytetarit të realizuara përmes platformës e-Kosova, që i pranon përmes ndërlidhjes nga AShI për këtë platformë, për ta zbatuar saktësisht ligjin për tatimin në pronë lidhur me pagesën. Në mënyrë që të bëhet komunikimi me institucionet e Republikës së Kosovës në kohë reale dhe të paraqitet gjendja e faturës gjithashtu në kohë reale për pagesën e realizuar nga qytetari.

   9.1. AShI të parandaloj pagesën e dyfishtë në modulin "Pagesa" të platformës e-Kosova, duke e njoftuar qytetarin se kjo pagesë është realizuar tashmë njëherë.

10. **Kontrollet sigurisë në aplikacion – monitorimi i gjurmëve të auditimit,** AShI të sigurojë politikat dhe procedruat për menaxhimin dhe monitorimin e gjurmëve të auditimit në sistemet e informacionit dhe të përcaktoj detyrat për monitorimin e gjurmëve në baza të rregullta duke siguruar resurset e nevojshme.

Shtojca I. Dizajni i auditimit

Fushat me rrezik dhe treguesit e problemit të auditimit

Platforma e-Kosova është një prej sistemeve më me rëndësi shtetërore, e klasifikuar edhe në nivel vendi, për rëndësinë që ka në ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë elektronike e cila ka për qëllim të bëj administratën më të qasshme, më transparente dhe më efikase. Ajo është e zhvilluar dhe menaxhuar nga Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (AShI) dhe synon të zvogëlojë varësinë nga sportelet fizike të institucioneve shtetërore.

Auditimi i kësaj teme është i rëndësishëm duke pasur parasysh edhe rekomandimet dhe çështjet e identifikuara në Auditimin e TI-së të realizuar më parë nga ZKA[31], duke qenë se e-Kosova është platforma kryesore për digjitalizimin e shërbimeve shtetërore, siguria dhe integriteti janë çështje kyçe për këtë platformë dhe për besimin e qytetarëve.

Gjithashtu, ne gjatë fazës parastudimore, pasi që shqyrtuam dokumentet lidhur me sistemet e TI-së dhe shërbimet për qytetarë, si dhe zhvilluam intervistat me zyrtarët përgjegjës për platformën e-Kosova identifikuam se pavarësisht progresit të bërë në digjitalizimin e shërbimeve publike, e-Kosova ende përballet me disa sfida të rëndësishme që janë:

- Mungesa e adresimit të çështjeve të sigurisë së informacionit në kontratat e platformës e-Kosova, si dhe mungesa e një politike të sigurisë së informacionit, pasi që rregullorja për sigurinë e informacionit me të cilën kanë funksionuar që nga viti 2010, tani nuk është në fuqi. Këto e bëjnë më të cënueshme sigurinë e informacionit dhe sigurinë kibernetike të këtij sistemi. Pasi që mungesa e procedurave dhe përditësimet e tyre në raport me zhvillimet e fundit të teknologjive brenda AShI-së, ka lënë pa mekanizma mbrojtës për sigurinë e informacionit dhe sigurinë kibernetike. Siç janë: Monitorimi i gjurmëve të aktiviteteve në sistemin e informacionit, monitorimi i gjurmëve për sigurinë kibernetike për parandalimin dhe zbulimin ndaj ndërhyrjeve. Mungesa e ndarjes së roleve dhe përgjegjësive të qasjeve dhe përgjegjësive në sistem. Lista e rreziqeve të mundshme dhe plani për menaxhimin e tyre. Procedura për reagimin ndaj incidenteve të sigurisë së informacionit. Si dhe mungesa e një liste të infrastrukturës kritike dhe plani për vazhdimësinë e biznesit.
    - Mungesa e mekanizmave për mbrojtjen e sigurisë së informacionit i cenon të dhënat e shërbimeve në e-Kosova. Ajo bëhet më e ndjeshme në rastin e procesimit të të dhënave lidhur me pagesat. E-Kosova ka shumë shërbime që përmbajnë modulin pagesat, prandaj mungesa e këtyre mekanizmave e bëjnë më të cenueshëm modulin e pagesave ndaj sulmeve të mundshme kibernetike.
- Ndërlidhja e kufizuar me sistemet e tjera shtetërore, e cila çon në verifikime manuale dhe vonesa në përditësimin e të dhënave për disa shërbime. Shërbimet më të përdorura dhe me qarkullimin më të shpeshtë të mjeteve financiare në baza të rregullta mujore që i prinë listës së shërbimeve në e-Kosova janë identifikuar me probleme të kësaj natyre:

[31] Menaxhimi i Projekteve për Sistemet e Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit – Raporti i Auditimit të TI-së (2023.)

- **Shtesat e fëmijëve**, në mungesë të ndërlidhjes me sistemet për identifikimin e rezidencës edhe qytetarët të cilët nuk jetojnë në Kosovë mund të marrin shtesa për fëmijë, pa plotësuar këtë kriter. Kjo ndodh si shkak i mungesës të një ndërveprimi të sistemeve dhe verifikimit të rezidencës së tyre.
- **Tatimi në pronë,** të dhënat e shërbimit të tatimit në pronë vijnë me ndërlidhje në platformën e-Kosova, prandaj siguria e kësaj ndërlidhje ka nevojë të testohet duke qenë se gjatë fazës parastudimore kemi identifikuar që për pjesën e sigurisë së informacionit për ndërlidhjen e shërbimeve ka shumë pak dokumentim. Ky shërbim është më i përdoruri nga qytetarët dhe ka elementin e pagesës që e bën edhe më të cenueshëm, prandaj ky shërbim ka mangësi në mekanizmat e sigurisë së informacionit.

- Mungesa e digjitalizimit për disa shërbime, veçanërisht për grupet e ndjeshme, si të moshuarit dhe personat me probleme shëndetësore. Një shërbim i rëndësishëm i identifikuar gjatë parastudimit është nevoja për prezencë fizike për vazhdimin e pensioneve, ku pensionistët duhet të paraqiten personalisht në zyrat për punë sociale. Kjo tregon nevojën për një analizë më të madhe gjatë digjitalizimit të proceseve dhe prioritizimit dhe menaxhimit të nevojave për digjitalizimin e shërbimeve për qytetarët, nga ana e vendimmarrësve për zhvillimin e kërkesave.

Shqyrtimi i treguesve të problemit të identifikuar nga burime të ndryshme, takimet e mbajtura me personat përgjegjës për identifikimin e çështjeve në platformën e-Kosova, si dhe nga vlerësimet tona të bazuara në Manualin Aktiv të Auditimit të TI-së[32] për identifikimin e fushave më me rrezik nga dokumentacioni i pranuar na orienton në problemin kryesor: platforma e-Kosova ka mangësi në zhvillimin dhe kontraktimin e sistemit të informacionit, në organizimin e sigurisë së informacionit dhe kontrollin e aplikacionit.

[32] Manuali Aktiv i Auditimit- është platformë e zhvilluar nga ITWG/EUROSAI dhe WGITA/INTOSAI, që përdoret për identifikimin e fushave më me rrezik, përcaktimin e pyetjeve, kritereve dhe metodologjisë së punës gjatë procesit të auditimit të TI-së.

Përshkrimi i sistemit

3.1. Ministria e Punëve të Brendshme

Misioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme është të sigurojë sundimin e ligjit dhe sigurinë publike në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Ministria përveç që ka përgjegjësi ndërtimin, ruajtjen dhe përmirësimin e sigurisë për të gjithë qytetarët e vendit, gjithashtu, përgatit dhe zbaton politika për administrimin dhe komunikimin e sistemeve, duke qenë një nga institucionet kyçe që menaxhon të dhënat elektronike në aspektet e sasisë, cilësisë dhe rëndësisë. Ministria funksionon përmes 8 agjencive dhe organeve të saj, duke përfshirë Agjencinë për Shoqërinë e Informacionit (AShI) dhe gjithashtu 13 departamente dhe divizione.

AShI është themeluar si agjenci ekzekutive qeveritare në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratën publike, ose pranë autoritetit më të lartë të administratës shtetërore të vendosur nga Qeveria dhe që tani është Ministria e Punëve të Brendshme.

Në vitin 2013, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligjin 04/L-145, në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për Organet Qeveritare të Shoqërisë së Informacionit i cili përcakton AShI-në si organin kryesor për zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Strukturat përgjegjëse për shoqërinë e informacionit në institucionet e Republikës së Kosovës sipas këtij ligji janë AShI dhe Struktura përkatëse organizative apo Zyrtari për menaxhimin e TIK-ut në IRK-të. Gjithashtu janë përcaktuar organet përgjegjëse për zhvillimin e shërbimeve të shoqërisë së informacionit në institucionet e Republikës së Kosovës, kompetencat, përgjegjësitë, organizimin dhe funksionimin e tyre.

Detyrat dhe Përgjegjësitë e AShI-së:

- Propozon dhe koordinon të gjitha politikat që lidhen me zhvillimet e TIK-ut në institucionet e Republikës së Kosovës;
- Përgatitë strategjinë për qeverisje elektronike dhe planin e saj të veprimit për miratim nga Qeveria dhe monitoron implementimin e tij;
- Menaxhon dhe mbikëqyrë implementimin e projekteve të TIK-ut në institucionet e Republikës së Kosovës;
- Përkrah zhvillimin e teknologjisë së informacionit, nxit investimet në fushën e shoqërisë së informacionit, zhvillimin e sistemeve të aftësimit në teknologjinë e informacionit dhe bën koordinimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e proceseve dhe të mekanizmave të qeverisjes elektronike në fushat e infrastrukturës së TI-së, zgjerimit të shërbimeve të internetit. Bën akumulimin, administrimin, përhapjen dhe ruajtjen e të dhënave, në Qendrën shtetërore të të dhënave elektronike;
- Përkrah zhvillimin e sigurisë dhe mbrojtjen e infrastrukturës komunikuese elektronike dhe të të dhënave, si dhe luftimin e krimit elektronik (cyber crime). Gjithashtu, bën menaxhimin dhe ruajtjen e pronës intelektuale dhe të drejtat në lidhje me bazat e të dhënave dhe softuerët, që janë pronë e shtetit, si dhe mbron të dhënat personale në formë elektronike, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe ndihmon qasjen në informata publike në formë elektronike;

- Në bashkëpunim me IKAP-in bën identifikimin e nevojave për aftësimin elektronik të Shoqërisë së Informacionit për punonjësit e institucioneve të Republikës së Kosovës;
- Shqyrton kërkesat për projektet e planifikuara dhe monitoron implementimin e tyre në pajtim me politikat dhe Strategjinë e Qeverisjes Elektronike;
- Koordinon aktivitetet për sigurinë e shërbimeve elektronike.

Përgjegjësitë për zhvillimin e këtyre funksioneve të saj AShI i ka organizuar në pesë drejtori, të cilat janë të paraqitura me figurën në vijim:



Figura 7. Organizimi i AShI-së

Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT), në bazë të Rregullores[33] për fushat e përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, ka përgjegjësitë për: Përgatitjen, hartimin, miratimin, zbatimin, vlerësimin dhe mbikëqyrjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e menaxhimit të financave publike dhe tatimeve. Në fushën e tatimit në pronë, ministria siguron zbatimin e legjislacionit tatimor dhe mbikëqyr rregullat për shpenzimin e parasë publike, duke kontribuar në menaxhimin e qëndrueshëm fiskal dhe ekonomik.
Për shtesat e fëmijëve, MFPT siguron përllogaritjen dhe ekzekutimin e skemave sociale, përfshirë përfitimet që lidhen me ndihmat për familjet dhe shtesat për fëmijët, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo nënkupton se ministria ka një funksion qendror në garantimin e mbështetjes financiare për qytetarët, duke përfshirë familjet me fëmijët, si dhe në platformën e-Kosova menaxhon dhe administron me të dhënat për shërbimet që ka rol dhe përgjegjësi, prandaj është përgjegjëse edhe për shërbimet më të mëdha, siç është shërbimi i tatimit në pronë dhe ai i shtesave të fëmijëve. MFPT ka 8 Agjencione dhe 18 Departamente, ku në kuadër te departamenteve bëjnë pjesë edhe Departamenti i Tatimit në Pronë, Departamenti i Skemave Sociale dhe Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative.

[33] **Rregullore (Qrk) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive**

Përgjegjësitë e këtyre departamenteve do të fokusohen vetëm për shërbimet që ofrohen përmes platformës e-Kosova dhe jo sistemeve bazë siç është tatimi në pronë por vetëm shërbimi brenda e-Kosova dhe jo sistemi bazë i tatimit në pronë.



Figura 8. Organizimi i departamenteve të MFPT-së të përfshira në fushë veprim

Fushëveprimi dhe pyetjet e auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi do të jetë Agjencia për Shoqërinë e Informacionit dhe departamentet përgjegjëse për administrimin, menaxhimin dhe sigurinë e platformës e-Kosova. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me departamentet përkatëse për Tatimin në Pronë dhe Menaxhimin e Skemave Sociale që administrojnë edhe shërbimet përkatëse në e-Kosova për tatimin në pronë dhe shtesat e fëmijëve.

Në AShI: Drejtorati i Racionalizimit të Proceseve Administrative; Drejtorati i Zhvillimit dhe Politikave të e-Qeverisjes; Drejtorati i Administrimit dhe Zhvillimit të Sistemeve Elektronike; Drejtorati i Shërbimeve Qendrore dhe Sigurisë; dhe Drejtorati i Rrjetit Shtetëror.

Në MFPT: Departamenti i Tatimit në Pronë; Departamenti i Skemave Sociale; dhe Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative.

Fokus i auditimit do të jetë siguria e informacionit dhe kontrollet e aplikacionit për sistemin e teknologjisë së informacionit, platforma e-Kosova. Auditimi do të mbulojë periudhën nga Janari i vitit 2024 deri në përfundim të auditimit.

Pyetjet audituese

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit ne kemi parashtruar pyetjet si në vijim:

1. *A janë adresuar kërkesat e sigurisë së informacionit në dokumentet kontraktuale për e-Kosova dhe a janë në përputhje me politikat e sigurisë së AShI-së?*
2. *Si i identifikon, përcakton prioritetet dhe menaxhon AShI-ja kërkesat e saj për platformën e-Kosova?*
3. *A është i sigurt komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm i sistemit të informacionit në e-Kosova?*

4. *A parandalohet qasja e paautorizuar dhe kopjimi ose shikimi i informacionit të ndjeshëm në e-Kosova?*
5. *A ekziston një politikë efektive e vazhdimësisë së biznesit në AShI?*
6. *A vlerësohet nëse të dhënat e vendosura gjatë hyrjes në aplikacion janë të vlefshme në bazën e të dhënave dhe nga personeli i autorizuar në platformën e-Kosova?*
7. *A siguron aplikacioni e-Kosova integritetin, vlefshmërinë dhe besueshmërinë e transaksioneve gjatë ciklit të përpunimit të të dhënave?*
8. *A sigurohet që informacioni dalës në e-Kosova është i plotë dhe i saktë para përdorimit të mëtejshëm dhe a ruhet në mënyrën e duhur?*
9. *A është informacioni i sigurt në aplikacionin e-Kosova kundrejt keqpërdorimeve?*

Kriteret e auditimit[34]

Kriteret e përdorura në këtë auditim rrjedhin nga Manuali Aktiv i Auditimit të TI-së[35]; Standardet ndërkombëtare për sigurinë e informacionit[36], si dhe Rregullorja e AShI-së për Koordinim në mes të AShI-së dhe IRK-ve[37].

Për të vlerësuar identifikimin e nevojave dhe adresimin e kërkesave të sigurisë së informacionit në kontratën për zhvillimin e sistemit e-Kosova janë vendosur kriteret e mëposhtme:

- Kërkesat e sigurisë së organizatës duhet të jenë të theksuara nga kontraktori në mënyrë të përshtatshme.[38]

  Marrëveshja me palët e jashtme që përfshin qasjen, përpunimin, komunikimin ose menaxhimin e informacionit ose strukturës së përpunimit të informacionit të organizatës, ose futjen e produkteve ose shërbimeve në sistemin për përpunimin e informacionit, është në përputhje me të gjitha kërkesat e duhura të sigurisë.[39]

Për të vlerësuar identifikimin e nevojave dhe adresimin e kërkesave për blerjen dhe zhvillimin e kontratës për zhvillimin e sistemit e-Kosova janë vendosur kriteret e mëposhtme:

- AShI duhet të analizon, përcakton prioritetet dhe menaxhon kërkesat për të siguruar që nevojat e përdoruesve të plotësohen në mënyrë optimale dhe me kosto efektive.[40]

Për të vlerësuar se AShI ka mekanizma për sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e biznesit janë vendosur kriteret e mëposhtme:

[34] Për më shumë informata konsultoni ISSAI 300, Criteria, p.7
[35] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është produkt i grupeve të punës së teknologjisë së informacionit të EUROSAI-t (WGITA) si dhe Iniciativës për zhvillim të INTOSAI-t (IDI) për përcaktimin e rregullave e standardeve të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.- më tej Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit.
[36] Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO/IEC 27000/01.
[37] Rregullore (Qrk) Nr. 02/2016 për Koordinim në mes të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Strukturave Organizative/ Zyrtarëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Institucionet e Republikës së Kosovës.
[38] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontraktimi, Siguria.
[39] ISO 27001 – Politikat e Sigurisë së Informacionit.
[40] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit –Blerja dhe zhvillimi.

- AShI duhet të sigurohet që ekzistojnë politika të përcaktuara për sigurinë e informacionit dhe ato janë të miratuara, të komunikuara dhe të zbatuara brenda organizatës.
  Politikat duhet të rishikohen në mënyrë të rregullt ose kur ka ndryshime të rëndësishme në organizatë, teknologji apo ligje të aplikueshme.[41]
  Politikat dhe procedurat duhet të formojnë një mjedis të qëndrueshëm menaxherial për komunikimet e brendshme dhe të jashtme.[42]

- Organizata duhet të sigurojë që ndërhyrjet janë zbuluar dhe do të zbulohen dhe luftohen.[43]
  Organizata duhet të sigurojë që ekzistojnë masa të përshtatshme për të parandaluar, zbuluar dhe rikuperuar nga kërcënimet e kodit të dëmshëm përmes politikave, kontrolleve teknike dhe ndërgjegjësimit të përdoruesve.[44]
  Agjencia e Shoqërisë së Informacionit duhet të kujdeset për sigurinë dhe mbrojtjen e infrastrukturës elektronike dhe të dhënave dhe koordinon aktivitetet për sigurinë e shërbimeve të TI-së.[45]

- Organizata duhet të ketë politikat organizative mbi vazhdimësinë e biznesit, të cilat përmbajnë detyrat dhe përgjegjësitë, qëllimin, kriteret e alokimit të burimeve/parimet, kërkesat për trajnim, orar të mirëmbajtjes, orarin e testimeve, planet backup, si dhe nivele e aprovimit.[46]
  Organizata duhet të ketë planin për të mbajtur dhe rikthyer operacionet e biznesit, për të siguruar disponueshmërinë e informacionit brenda nivelit të kërkuar dhe në kohën e përcaktuar pas një ndërprerjeje ose dështimi të proceseve të biznesit. Ky plan duhet të identifikoj rreziqet me të cilat përballet organizata, identifikon asetet kritike të biznesit, identifikon ndikimet e incidenteve, merr në konsideratë zbatimin e kontrolleve shtesë parandaluese dhe dokumenton planet e vijueshmërisë së biznesit duke adresuar kërkesat e sigurisë. Duhet të sigurojë që plani përfshin identifikimin dhe miratimin e përgjegjësive, përcaktimin e humbjes së pranueshme, zbatimin e procedurave të rikuperimit dhe restaurimit, dokumentimin e procedurave dhe testimin e rregullt.[47]
  Regjistrat shtetërorë dhe shërbimet elektronike të IRK-ve duhet të hostohen në QDHSH ose në Qendrat e tyre të të Dhënave, por me kusht që një kopje rezervë (backup) ta kenë në QDHSH. Kopjet rezervë të aplikacioneve dhe bazave të të dhënave bëhen konform procedurave standarde të operimit dhe duhet të ruhen në konfidencialitet në bazë të ligjit.[48]

[41] ISO/IEC 27002:2022 – Politikat për Sigurinë e Informacionit.
[42] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit - Informacioni dhe Siguria Kibernetike, Komunikimet dhe Menaxhimi i Operacioneve.
[43] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Informacioni dhe Siguria Kibernetike, Sistemi i Zbulimit dhe Mbrojtjes nga Ndërhyrja .
[44] ISO 27001 – Kriteret për mbrojtjen ndaj kodit të dëmshëm (malware).
[45] Rregullore (Qrk) Nr. 02/2016 për Koordinim në mes të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Strukturave Organizative/ Zyrtarëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Institucionet e Republikës së Kosovës.
[46] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – PVB-PRF, Politika dhe plani i organizatës për Vazhdimësinë e Biznesit.
[47] ISO 27001 – Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit.
[48] Rregullore (Qrk) Nr. 02/2016 për Koordinim në mes të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Strukturave Organizative/ Zyrtarëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Institucionet e Republikës së Kosovës.

Për të vlerësuar se për platformën e-Kosova ekzistojnë mekanizma kontrollues të aplikacionit të cilët mundësojnë qasjen e sigurt logjike (nga ana softuerike) dhe të besueshme në sistemin informativ janë vendosur kriteret e mëposhtme:

- Rregullat e vlefshmërisë duhet të jenë të mirë-hartuara, të dokumentuara dhe të zbatuara në ndërveprimin e hyrjeve (inputit); duhet të dokumentohen metoda të ndryshme për futjen e të dhënave; të dhëna jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; kriteret e vlefshmërisë përditësohen në mënyrën e duhur dhe të autorizuar; duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së kontrolleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit.[49]

- Për të dhënat hyrëse në aplikacion duhet të ketë një sistem të qartë dhe kompakt për trajtimin e gabimeve duke paraqitur llojin e problemit në mënyrë që të ndërmerren veprime korrigjuese për çdo lloj gabimi. Gabimet duhet të korrigjohen përshtatshmërisht përpara përpunimit të transaksioneve. Regjistrimet duhet të rishikohen periodikisht dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme korrigjuese.[50]

  Agjencia e përkrah dhe koordinon aktivitetet mes IRK-ve që bazat e të dhënave/regjistrat e rëndësishëm të ndërveprojnë në mes tyre.[51]

- Në aplikacion duhet të ketë të vendosura nivelet e autorizimit të transaksioneve dhe duhet të zbatohen nëpërmjet kontrolleve të ndryshme; të ekzistojë ndarje e saktë e detyrave për futjen e të dhënave; të ekzistojnë kontrolle kompensues për rastet në të cilat ndarja e detyrave nuk është e mundur.[52]

- Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në përputhje me sjelljen e pritur.[53]

  Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në mënyrë të kontrolluar dhe të besueshme, duke siguruar që ato të përputhen me rregullat e biznesit, parametrat e konfigurimit dhe skenarët e parashikuar të përpunimit.[54]

- Organizata duhet të ketë të hartuara procedurat për të siguruar se plotësia dhe saktësia rezultateve të aplikacioneve është vlerësuar përpara përdorimit të rezultatit nga përpunimi i mëtejshëm, përfshirë përpunimin e përdoruesve final; të mundësohet gjurmimi i rezultatit të aplikacionit; rezultati të rishikohet për arsyeshmëri dhe saktësi; kontrollet e plotësisë dhe të saktësisë të jenë efektive.[55]

- Duhet të ekzistojnë gjurmë të mjaftueshme auditimit që kapin modifikimet, regjistrimet e autorizuara të transaksioneve kritike; gjurmët e auditimit rishikohen periodikisht për të

[49] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.
[50] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.
[51] Rregullore (Qrk) Nr. 02/2016 për Koordinim në mes të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Strukturave Organizative/ Zyrtarëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Institucionet e Republikës së Kosovës
[52] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.
[53] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e përpunimit
[54] Përdorimi i udhëzimeve të COBIT (sidomos DSS05 dhe BAI09) për kontrollin e proceseve dhe sigurimin e besueshmërisë së përpunimit të transaksioneve.
[55] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e të dhënave dalëse.

monitoruar aktivitetet jonormale; gjurmët e auditimit mirëmbahen dhe ruhen në mënyrën e duhur; numra unikë dhe sekuencialë, ose identifikues duhet të jenë të përcaktuar për çdo transaksion.[56]

- Të dhënat e aplikacionit duhet të mbrohen në përputhje me standardet e sigurisë dhe manualin e auditimit të TI-së. Duhet të zbatohen kontrolle efektive të qasjes logjike dhe fizike, siç përcaktohet në domainin mbi Sigurinë e Informacionit, për të siguruar autentifikimin, autorizimin dhe monitorimin e aksesit. Gjithashtu, aplikacioni duhet të ketë një plan të dokumentuar për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë, duke përfshirë mekanizma të sigurt të backup-it dhe rikuperimit, sipas domainit mbi PVB/PRF. Planet e sigurisë dhe rimëkëmbjes duhet të testohen rregullisht për të garantuar vijueshmërinë e biznesit dhe mbrojtjen e informacionit.[57]

Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve audituese dhe me qëllim të mbështetjes së konkluzioneve të auditimit do të zbatojmë metodologjinë në vijim:

Për të vlerësuar identifikimin e nevojave dhe adresimin e kërkesave të sigurisë së informacionit në kontratat e platformës e-Kosova do të realizohen:

- Rishikimi i dokumenteve kontraktuale. Rishikimi i kontratës fillestare për zhvillimin e platformës e-Kosova, kontratën aktuale për mirëmbajtje dhe avancim të platformës e-Kosova, si dhe dosjen e tenderit me termat specifike. Gjithashtu rishikimi i politikave dhe procedurave të AShI-së për sigurinë e informacionit.

Për të vlerësuar identifikimin e nevojave dhe adresimin dhe prioritarizimin e kërkesave të qytetarëve në kontratat e platformës e-Kosova realizohen:

- Rishikimi i kërkesave për të përcaktuar nëse ato përfshijnë autorin, datën, prioritetin, koston, rrezikun dhe elemente të tjera. Rishikimi dhe analizimi i kërkesave ose komenteve mbi kërkesat nga pronarët e biznesit – Qeveria, vendimmarrësit ose palët e interesuara për të përcaktuar nëse janë mbledhur dhe përmbledhur të gjitha pikëpamjet për një analizë të përshtatshme (pranimi, shtyrja, refuzimi, etj.). Rishikimi i matricës së gjurmueshmërisë për të përcaktuar nëse kërkesat e miratuara janë caktuar për projekte zhvillimi dhe nëse ndiqen deri në përmbyllje kur implementohen. Rishikimi i kritereve për përcaktimin e prioritetit të kërkesave për të vlerësuar nëse përfshijnë elemente si kostoja, nevojat themelore të qytetarëve, çështjet emergjente dhe kërkesat e reja.

Për të vlerësuar se për platformën e-Kosova ka mekanizma për sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e biznesit realizohen:

- Analizimi i politikave dhe procedurave tëe organizatës nëse përshtaten me nevojat e qytetarëve duke i krahasuar ato. Verifikimi sesi organizata dokumenton procedurat e veta dhe si i bën të disponueshme për të gjithë përdoruesit. Intervistimi i stafit të niveleve të ndryshme për të ekzaminuar nëse të gjitha procedurat për trajtimin e të dhënave janë të

[56] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e sigurisë së aplikacionit.
[57] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e sigurisë së aplikacionit.

njohura për punonjësit. Kontrollimi sesa shpesh rishikohen dhe përditësohen procedurat e trajtimit të të dhënave dhe komunikimeve. Rishikimi i strategjisë se sigurisë kibernetike nëse ka dhe asiguron që ajo mbulon mbrojtjen e aseteve kritike.
- Verifikimi i rregulloreve për trajtimin e ndërhyrjeve fizike ne hapësirat ku janë te vendosura pajisjet. Analizimi i raporteve të incidenteve. Si dhe identifikimi që organizata ka një politikë të qartë për parandalimin e qasjeve të paautorizuara.
- Rishikimi i dokumenteve për të vlerësuar nëse politikat përputhen me politikat e përgjithshme të TI-së dhe adresojnë kërkesat për vazhdimësi biznesi. Zhvillimi i intervistave me personelin për të parë sa shpesh përditësohen politikat. Verifikimi i politikave se si janë aprovuar dhe a janë të përditësuara, si dhe të vlerësohet nëse këto politika janë të kuptueshme për stafin.

Për të vlerësuar se në platformën e-Kosova ekzistojnë mekanizma kontrollues të aplikacionit të cilët mundësojnë qasjen e sigurt logjike dhe të besueshme në sistemin informativ realizohen:

- Analizimi i rregullave, kërkesave, dokumentacionit të aplikacioneve dhe të intervistohen personat përgjegjës të proceseve të biznesit për të përcaktuar se cilat rregulla të vlefshmërisë duhet të sigurohen në procesin e biznesit që po vlerësohet. Rishikimi nëse rregullat e vlefshmërisë janë të mirë hartuara dhe të dokumentuara. Verifikimi nëse kontrollet e vlefshmërisë për të dhënat hyrëse janë në zbatim, ekzekutimi i aplikacionit në mjedis testimi dhe testimi i ndërveprimeve të ndryshme për të dhënat e hyra.
- Trajtimi i gabimeve të aplikacionit me zhvilluesin e tij ose administratorin. Verifikimi dhe konfirmimi se a ekzistojnë politika dhe procedura për trajtimin e transaksioneve që dështojnë në kontrollet e modifikimit dhe vlefshmërisë. Verifikimi nëse sistemi ofron mesazhe për çdo lloj gabimi (në nivel fushe ose transaksioni), mesazhe të cilat mund të mos përputhen me vlefshmërinë ose modifikimin. Verifikimi sesi funksionon aplikacioni nëse të dhënat refuzohen nga kontrollet në hyrje. Kontrollimi nëse elementet e të dhënave regjistrohen ose nëse plotësohen automatikisht.
- Inspektimi dhe konfirmimi nëse dizajnimi i sistemit ofron listë të autorizuar për përdorim. Verifikimi nëpërmjet inspektimit të listës së autorizimit, se nivelet e autorizimit janë të mirë përcaktuara për çdo grup transaksionesh. Vlerësimi nëse rregullat e autorizimit për vendosjen e të dhënave, modifikimin, pranimin, refuzimin dhe abuzimin me to, janë të mirë hartuara dhe përcaktuara. Nëse ekziston një tabelë për ndarjen e detyrave, mënyra se si janë të shpërndara detyrat kryesore dhe funksionet e punës, si dhe transaksioneve të lejuara dhe më pas analizojmë listën e përdoruesve dhe listën e privilegjeve të qasjeve të përdoruesve.
- Identifikohen shërbimet e ofruara në platformë dhe grupohen ato sipas rëndësisë të shërbimit që ofron. Rishikimi i dokumentimit të platformës për të verifikuar që është i përshtatshëm, siguron integritet dhe besueshmëri gjatë ciklit të përpunimit të transaksionit.
- Krijohet një listë e verifikimit të të dhënave hyrëse nëse ka ndonjë rishikim paraprak për shërbimet e ofruara. Identifikimi nëse për shërbime të caktuara, sistemi e-Kosova ka lidhje me sistemet bazë dhe bën validimin e të dhënave nga sistemi fundor. Vlerësimi nëse informacionet dalëse pas përpunimit në sistemin e-Kosova janë të sakta dhe të plota dhe që gabimet e shfaqura janë të identifikuara.
- Analizimi dhe Rishikimi i politikave dhe procedurave për ruajtjen e gjurmëve të auditimit dhe mënyra e verifikimit të tyre. Verifikimi i gjurmëve të auditimit dhe dokumente të tjera për të verifikuar që gjurma e auditimit është krijuar në mënyrë efektive. Identifikimi se cilët janë personat e autorizuar për shfuqizimin ose fshirjen e gjurmëve të auditimit. Sigurimi që qasja ndaj gjurmëve të auditimit është e kufizuar dhe vetëm personat e autorizuar mund të aksesojnë ato. Vlerësimi nëse gjurmët janë të mbrojtura nga modifikimet dhe nëse ka

identifikues unikë për çdo transaksion. Vlerësimi nëse platforma e-Kosova ka integritetin dhe besueshmërinë e nevojshme.
- Rishikimi dhe analizimi i dokumentacionit të platformës për të parë nëse informacioni i platformës është i sigurt kundër keqpërdorimeve. Intervistimi i stafit të TI-së për të parë se si i kuptojnë ata mekanizmat e sigurisë të zbatuara në aplikacion.

Dokumentet relevante

Ligjet
Ligji Nr. 04/L-145 për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit

Ky ligj përcakton institucionet kompetente, funksionet dhe përgjegjësitë e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e teknologjisë së informacionit në institucionet e Republikës së Kosovës, themelimin e Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit, si dhe konsolidimin e funksioneve dhe të përgjegjësive në fushën e zbatimit të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (TIK).

Ligji Nr. 06/L-005 - për Tatimin në Pronën e Paluajtshme
Ky Ligj vendos tatimin mbi pronën e paluajtshme dhe përcakton rregullat dhe procedurat themelore për administrimin e tatimit në pronën e paluajtshme nga komunat dhe Ministria e Financave. Dispozitat e këtij Ligji janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe njësitë e tyre përkatëse, përgjegjëse për zbatimin e këtij Ligji, për personat që janë të obliguar të paguajnë tatimin në pronë, si dhe për personat e tjerë të cilët janë të obliguar të zbatojnë detyrimet ligjore, sipas dispozitave të përcaktuara me këtë Ligj.

Rregulloret
Rregullore (Qrk) Nr. 02/2016 për Koordinim në mes të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Strukturave Organizative/ Zyrtarëve të Teknologjisë së Informacionit dhe e Komunikimit në Institucionet e Republikës së Kosovës

Me këtë Rregullore janë vendosur standardet, mënyra e funksionimit dhe koordinimit të aktiviteteve ndërmjet të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe strukturave apo zyrtarëve të TIK-ut të IRK.
Mbikëqyrës për implementimin e kësaj rregullore është ASHI.

Rregullore (Map) Nr. 02/2015 për Standarde për Softuer dhe Harduer

Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i standardeve të përdorimit të softuerit dhe harduer nga zyrtarët e institucioneve të Republikës së Kosovës.
Kjo rregullore ka përcaktuar edhe blerjen, instalimin dhe shfrytëzimin e licencave që shfrytëzohen nga IRK-të.

Rregullore (Qrk) Nr. 06/2018 për Menaxhimin e Projekteve në Fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i standardeve dhe rregullave unike për inicimin, planifikimin, ekzekutimin, monitorimin dhe kontrollin, si dhe përmbylljen e procesit të menaxhimit të projekteve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (në tekstin e mëtejmë: TIK) në institucionet e Republikës së Kosovës.

Rregullore (Qrk) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive

Kjo rregullore përcakton fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Rregullore (ZKM) Nr. 02/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Shtojca II. Letër konfirmimi

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

DATË/A:	22.08.2025
REFERENCË:	/ 2024
PËR/ZA/TO:	z. Samir Zymberi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Teknologjisë Informative, Zyra Kombëtare e Auditimit
NGA/OD/FROM:	z. Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër konfirmimi për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit Platforma e Shërbimeve online e-Kosova

I nderuar z. Zymberi,

Përmes kësaj, konfirmojmë se:

- Kemi pranuar draft Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit Platforma e Shërbimeve online e-Kosova (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- Lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna pajtohemi, dhe nuk kemi ndonjë koment shtesë për përmbajtjen e Raportit;
- Ju njoftojmë se brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit përfundimtar, do t'ju dorëzojmë një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, i cili do të përfshijë edhe afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

Arton Ahmeti

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

1

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit **Platforma e shërbimeve online e-Kosova,** dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: 31.07.2025

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **Platforma e shërbimeve online e-Kosova** (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Ministri//Kryetari//Kryeshefi Ekzekutiv/Drejtori i Përgjithshëm

z. Xhelal Svecla
Ministër në detyrë i Punëve të Brendshme

Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës